



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.04/L-144, në pajtim me nenin 2 të Rregullores QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 15.2 shkronja d) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2018, mori:

VENDIM

PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN E PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM

Neni 1

Themelohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës, në këtë përbërje:

1. Hamdi Jaha, nga Ekzekutivi i Komunës
2. Durim Salihu, nga Ekzekutivi i Komunës
3. Vezir Januzi, nga Ekzekutivi i Komunës
4. Afrim Shabani, nga Kuvendi i Komunës
5. Florent Hasani, nga Kuvendi i Komunës
6. Arbër Blaku, nga Kuvendi i Komunës
7. Demokrat Beqiri, nga Shoqëria Civile

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara në nenet 8 dhe 9 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe në Rregulloren QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Drejtoritë dhe shërbimet përkatëse të Administratës së Komunës, Komisionit vlerësues i ofrojnë përkrahje dhe ndihmë teknike – profesionale gjatë procesit të vlerësimit për dhënie të pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/04-0026807/18
Podujevë,
28 mars 2018

